



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_246_06_09**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 20.08.2009
- Aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë **A.nr.589/10**

në seancën e mbajtur më datë 08 nëntor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Z.P. ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_246_06_09 i datës 25.06.2009.

A r s y e t i m

Me datë 11.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në sektorin e faturimit në KEK duke kundërshtuar faturat e energjisë elektrike e më saktësisht taksat mujore si dhe taksat për pagesën e PEP – RTK.

Me datë 25.02.2009 Departamenti për konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij me arsyetimin se ky konsumator në KEK figuron si konsumator aktiv pavarësisht se i njëjti nuk ka shpenzime është ngarkuar me tarifë fikse si dhe tarifë për pagesën e emetuesit publik RTK, e cila pagesë është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të parapara me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/12, ku theksohet se çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është obliguar të paguaj pagesën për PEP-RTK.

Me datë 12.07.2005 konsumatori ka nënshkruar me KEK-un kontratën për rregullimin e borxhit të energjisë elektrike në vlerën prej 509.36€ dhe pranon se borxhi i akumuluar është i drejtë dhe ta paguaj sipas marrëveshjes së kontratës për rregullimin e borxhit.

Me datë 27.04.2006 është anuluar kontrata për rregullimin e borxhit nga ana e KEK-ut pasi që konsumatori ka dështuar ti përmbahet kushteve të kontratës, në kohën e anulimit të kontratës borxhi i konsumatorit ka qenë 494.68€, dhe nga kjo kohë konsumatori faturohet me taksën e emetuesit publik dhe tarifën fikse.



Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 08.06.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas shqyrtimit të ankesës së konsumatorit me datë 25.06.2009 ka nxjerr vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit dhe ka ardhur në përfundim se: 1) Konsumatori duhet të bëjë të gjitha pagesat e grumbulluara dhe të parashtrorj kërkesën në KEK-sh.a për mbylljen e llogarisë. 2) KEK-u nuk duhet ta faturorj konsumatorin me tarifën fikse dhe taksën e emetuesit publik qe nga momenti kur konsumatori shlyen detyrimet ndaj KEK-ut dhe parashtron kërkesën mbylljen e llogarisë.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së **ZRRE/DMK_V_246_06_09**, konsumatori me datë 20.08.2009 ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të faturimit të pa bazë pasi që unë si konsumator nuk jam duke bërë shpenzime në këtë pikë matëse dhe si rezultat i saj ngarkohem me taksa fikse për energji dhe taksë për pagesën e emetuesit publik RTK.

Baza e kundërshtimeve e konsumatorit të theksuara në ankesë është se i njëjti edhe përkundër faktit se kjo pikë matëse nuk ka bërë harxhime të energjisë elektrike dhe se ky lokal është i mbyllur nga viti 1999 pasi është një ndërtesë e vjetër dhe nuk ka destinim dhe nuk ka kush te punoj në të që nga kjo periudhë. Gjithashtu i njëjti thekson se nga KEK jam ngarkuar në formë paushallë dhe me taksën për pagesën e emetuesit publik RTK, pasi tani lokali ka funksionin e një garazhe ku kemi vendosur disa gjëra të vjetra dhe për disa vite ngarkohem me taksa të kundërligjshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 08 nëntor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara nga ana e konsumatorit. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të shkresave të lëndës nuk ka hasur në asnjë dëshmi se ky konsumator ka bërë kërkesë në KEK, për pasivizimin e njehsorit elektrik. Gjithashtu nga transaksionet e konsumatorit shihet se i njëjti me datë 12.07.2005 ka nënshkruar me KEK-un kontratën për rregullimin e borxhit të energjisë elektrike në vlerën prej 509.36€ dhe ka pranuar se borxhi i akumuluar është i drejtë dhe ta paguaj sipas marrëveshjes së kontratës për rregullimin e borxhit. Po ashtu nga pasqyra financiare shihet se në një periudhë kohore i njëjti ka bërë herë pas herë edhe pagesa te energjisë elektrike gjë që tregon se ky konsumator ka shpreh gatishmëri për pagesën e energjisë elektrike për atë periudhë kohore edhe për kundër faktit që thekson se nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë pas vitit 1999 këtë pikë matëse.

Bordi i ZRRE-së, ka shqyrtuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit në ankesë nga ana e konsumatorit ku thekson se përveç pagesës së taksës fikse për energji është detyruar të paguaj edhe një taks tjetër për emetuesin publik RTK. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së, konsideron se edhe me këtë rast KEK e poashtu edhe DMK/ZRRE, ka vepruar konform dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut, 2003/12 e më vonë e njëjta është zavendsua edhe me Ligjin Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës ku theksohet të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës më datë 16 tetor 2009 ka nxjerr një masë të përkohshme ku ka pezulluar faturimin e taksës së RTK-së në faturat e KEK-ut deri në marrjen e një vendimi meritor, ky vendim nuk ka pasur efekt retroaktiv sa i përket pagesave që janë bërë para nxjerrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar se të gjitha mjetet e paguara do të thotë para nxjerrjes së këtij vendimi janë mjete që i ka marr vet RTK-ja, dhe se këto mjete nuk janë marr nga furnizuesi publik KEK atëherë, ndërsa për mjetet tjera të pa inkasuara për taksën e RTK-së, KEK i ka shlyer nga transaksioni i konsumatorit pasi që ka konsiderua se nuk janë borxhe te KEK-ut.



Me që shqyrtimi I ankesës së konsumatorit është vonuar për një periudhë kohore dhe ankesa e konsumatorit nuk ka mundur të shqyrtohet brenda afatit ligjor nga Bordi I ZRRE-së, konsumatori ka hapur konflikt administrativ në gjykatë për heshtje administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me date 17.10.2013, ka marr aktgjykim me të cilën ka **aprovuar** padinë e paditësit Z.P., ku ka urdhëruar Bordin e ZRRE-së, që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi sipas ankesës së paditësit të ushtruar kundër vendimit të protokolluar nr. 592/09 I dates 26.06.2009 I lëshuar nga ZRRE me të cilën është ngarkuar me takes fikse dhe taksë të emituesit publik, dhe të njëjtin t'ia dorëzoj paditësit sipas procedures së përcaktuar me ligj.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 08.11.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_246_06_09, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar